

Statistikat e Bujqësisë

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	7
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja e ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave	10
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente.....	11
Aneks	11

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Tokës dhe Prodhimit Bimor, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.
1.3. Personi i kontaktit	Mimoza Dushkaj
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në Sektorin e Statistikave të Tokës dhe Prodhimit Bimor
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	MDushkaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / 240
1.8. Numri i faksit	+355 (4) 228 300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	25.06.2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	25.06.2021
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	25.06.2021
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Statistikat e bujqësisë japin një informacion të detajuar mbi aktivitetet bujqësore në Shqipëri, për sipërfaqjen e mbjellë, sipërfaqen prodhuese, sipërfaqe të vjelë, prodhimin, numrin e rrënjëve të drufrutorëve gjithësej dhe në prodhim, si dhe rendimentin sipas kulturave bujqësore. Gjithashtu japin informacion te detajuar mbi produktet organike të çertifikuara, mjetet mekanike të përdorura dhe ujitjen e tokës.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi i përdorur në Statistikat e Bujqësisë i referohet klasifikimeve dhe përkufizimeve sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

	<ul style="list-style-type: none"> • EU (EC) No 543/2009 on Crop Statistics. • NACE Rev.2 - Statistical classification of economic activities
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Statistikat e bujqësisë mbulojnë drithërat, bimët industriale, të tjera bimë të arave, perimet, frutat, agrumet, ullirin, vreshtat, produktet organike të çertifikuara, mjetet mekanike të përdorura dhe ujitjen e tokës.</p>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Njësia Ekonomike Bujqësore (NJEB) Njësia Ekonomike Bujqësore (NJEB) është njësi e vetme, teknike ekonomike, e përcaktuar në një drejtim unik, nga terreni dhe pse në parcela jo të vazhdueshme, në të cilën realizohet prodhimi bujqësor dhe blegtoral që drejtohet nga një person i vetëm ose grup personash, për realizimin e veprimtarive bujqësore – blegtorale.</p> <p>Përdorimi i tokës Sipërfaqja gjithsej e njësisë ekonomike bujqësore (fermës) është tërësia e terrenit të përbërë nga shuma e sipërfaqes bujqësore të përdorur (SBP) dhe sipërfaqes së tokës tjetër. Sipërfaqja bujqësore e përdorur (SBP) përbëhet nga: tokë e punueshme (arë), tokë e zënë me kultura drufrutore, kopshtet e shtëpive dhe kullotat e livadhet.</p> <p>Tokë e punueshme Toka e punueshme është toka e pluguar ose e lëruar rregullisht, sipas një sistemi të qarkullimit bimor. Qarkullimi bimor është praktika e rritjes alternative të kulturave bimore njëvjeçare në një fushë specifike sipas një modeli ose renditje të planifikuar në vitet prodhuese pasuese. Normalisht, kulturat njëvjeçare ndryshojnë çdo vit, por ato mund të jenë edhe shumëvjeçare (jonxhë). Për të dalluar tokën e punueshme nga toka e zënë me kultura drufrutore ose kullota e livadhe përdoret një prag prej pesë vjetesh. Sipërfaqja e kultivuar me bimë arash, është sipërfaqja e mbjellë me bimë arash në vitin bujqësor të dhënë. Këtu bëhet fjalë për sipërfaqe me kultura kryesore (të para). Këto kultura kryesore, normalisht kanë vlerë ekonomike më të lartë se kulturat e tjera dhe zënë tokën në pjesën më të madhe të vitit. Kulturat kryesore janë drithrat e bukës, kulturat e pranverës misri kokërr, patatja, fasulja, bimët industriale, foragjeret shumëvjeçare, etj.</p> <p>Sipërfaqja e mbjellë me drufrutorë Sipërfaqja me drufrutorë, është sipërfaqja e tokës e zënë me pemë frutore, ullinj, agrume dhe vreshta. Llogaritet vetëm sipërfaqja e mbjellë në blloqe me kultura drufrutore.</p> <p>Kopshtet e shtëpive Kopshtet e shtëpive janë sipërfaqet e caktuara të tokës për rritjen e produkteve bujqësore, me të cilat synohet të plotësohen nevojat e fermerit dhe të familjes së tij, zakonisht kopshtet e shtëpive janë të ndara nga pjesa e tokës punueshme.</p> <p>Sipërfaqja e mbjellë me drufrutorë Sipërfaqja me drufrutorë, është sipërfaqja e tokës e zënë me pemë frutore, ullinj, agrume dhe vreshta. Llogaritet vetëm sipërfaqja e mbjellë në blloqe me kultura drufrutore.</p>

	<p>Livadhet dhe kullotat Livadhet dhe kullotat, janë sipërfaqe të zëna me bimë barishtore shumëvjeçare që zënë terrenin për një periudhë relativisht të gjatë kohe, mbi 5 vjet nëpërmjet kultivimit ose rritjes natyrore. Sipërfaqja e tokës tjetër përbëhet nga: sipërfaqja e zënë nga pyjet, sipërfaqja bujqësore e papërdorur dhe sipërfaqja jo bujqësore.</p> <p>Pyjet Pyll është sipërfaqja e tokës më e madhe se 1 dynym, me drurë pyjorë në formë grumbulli, të cilët mbulojnë mbi 30 % të saj dhe me potencial për të arritur lartësi mbi 3 m, i cili përfaqëson një ekosistem kompleks dhe shumëfunksional, me ndikime në mjedisin rrethues.</p> <p>Tokë bujqësore e papërdorur Tokë bujqësore e papërdorur është sipërfaqe e përdorur paraprakisht si sipërfaqe bujqësore, e cila gjatë dy ose me shumë viteve të njëpasnjëshme nuk është punuar për arsye ekonomike, sociale e të tjera.</p> <p>Sipërfaqe jo bujqësore Sipërfaqe jo bujqësore është toka e zënë nga objekte, rrugë, gurore, tokë jo-pjellore, shkëmbinj, etj.</p> <p>Vit prodhimi Me vit prodhimi nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.</p> <p>Sipërfaqe e kultivuar Sipërfaqe e kultivuar korespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore specifike gjatë një viti të dhënë, nga e cila përjashtohet sipërfaqja e dëmtuar nga dëmtues natyror (përmytjet, zjarre etj). Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e kulturave të para dhe të dyta.</p> <p>Sipërfaqe prodhuese e drufrutorëve Sipërfaqe prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja që potencialisht jep prodhim. Përjashtohet sipërfaqja e pemtoreve të reja, blloqet extensive të drufrutorëve dhe ato të degraduara.</p> <p>Serrë Serrë është ambjenti i mbuluar me xham apo me mbulesë të lartë, (që lejon kalimin e personave apo mjeteve mekanike), të fiksuara apo të lëvizshme (xham ose plastikë e fortë ose fleksibël), ku bimët kultivohen gjatë gjithë periudhës apo për pjesën më të madhe të rritjes saj.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e vrojtuar është Njësia Ekonomike Bujqësore (NJEB).
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore janë të gjitha NJEB në territorin e Shqipërisë. Të dhëna për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuesë në nivel bashkie.

3.7. Zona e referencës	Statistikat e Bujqësisë mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat datojnë që nga viti 2012.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Njësia matëse e përdorur është Ha, Ton dhe kv/ha.
5. Periudha e referencës	Periudha e referencës për Prodhimin Bujqësor është viti kalendarik, 01 Janar - 31 Dhjetor 2020. Për Sipërfaqen periudha e referencës konsiderohet viti bujqësor, 01 tetor 2019 - 30 shtator 2020.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore për mbledhjen e statistikave bujqësore janë :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021 <p>Klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së janë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja Evropiane (KE) Nr. 543/2009 mbi Statistikat e Bujqësisë • Rregullorja e Deleuar e Komisionit (BE) 2015/1557 e 13 Korrik 2015 për ndryshimin e Rregullores (KE) Nr. 543/2009 të Parlamentit Evropian • NVE Rev.2 - Statistical classification of economic activities
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat administrative të Bujqësisë transmetohen në EUROSTAT, nëpërmjet platformës eDAMIS.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga NjEB konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti -	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore.

trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit, në fund të vitit paraardhës. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	<p>Kalendari i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it.</p>
8.3. Aksesit i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikant zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara (me postë ose email); 3. Publikimi (Statistikat e Blegtorisë, Vjetari Statistikor, Vjetari Rajonal, Shqipëria në shifra). 4. Seksioni Kërkesa të dhënash, për përdoruesit e jashtëm.

9. Shpeshhtësia e shpërndarjes	Statistikat administrativë të Bujqësisë publikohen në baza vjetore.
10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për media përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të Bujqësisë si: drithërat, bimët industriale, rrënjoret, fasulet, perimet, të tjera bimë të arave, frutat, agrumet, ullirin dhe vreshtat. Njoftimi për shtyp i Bujqësisë publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet për Statistikat e Bujqësisë gjenden të botuara në botimin “ Statistikat e Bujqësisë ”, “ Vjetari Statistikor ”, “ Vjetari Statistikor Rajonal ” dhe “ Shqipëria në shifra ”. Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT.
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat për Statistikat e Bujqësisë janë të publikuara në faqen zyrtare të INSTAT: seksioni Databaza .
10.4. Aksesi në të dhënat mikro	Të dhënat mbi Statistikat e Bujqësisë janë të dhëna administrative dhe si të tilla niveli më i detajuar i të dhënave që merren është në nivel bashkie. Pra, INSTAT nuk disponon të dhëna në nivel mikro për Statistikat e Bujqësisë.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kërkesë të dhënash .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u japin përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë e përdorur për statistikave të Bujqësisë.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Tokës dhe Prodhimit Bimor dokumenton gjithë procesin dhe procedurat e statistikave administrativë të bujqësisë për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për statistikave Zyrtare”, Nr.17/2018, datë 17.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e

	<p>procese dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve. Procesi i hedhjes së të dhënave, është i programuar që minimizojë gabimet që vijnë nga procesi i mbledhjes së të dhënave. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave merr masa për të reduktuar mos-përgjigjet. Të dhënat e mbledhura krahasohen në lidhje me koherencën e brendshme, burimet administrative apo anketat e tjera pranë familjeve që INSTAT realizon duke garantuar një produkt final cilësor.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Të dhëna për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuese në nivel bashkie. Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit bimor bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave në vite.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e Statistikave të Bujqësisë ndahen në përdorues të brendshëm dhe të përdorues të jashtëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përdorues të jashtëm <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike • Universitetet • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare • Bizneset • Kërkuar, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. ➤ Përdorues të brendshëm <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare • Drejtoria e Statistikave Ekonomike • Drejtoria e Statistikave Sociale • Drejtoria e Sektorit Real <p>të cilët përdorin statistikën e bujqësisë si input në punën e tyre.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me “Statistikat e Bujqësisë” për vitin 2020 janë rreth 13,201.</p> <p>Gjatë 2020, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Bujqësisë është vlerësuar me 3.68 (73.6 %) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave për statistikën e bujqësisë gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregullore të ndjekura. Plotshmërisë së treguesve në nivel të agreguar është në përputhje të plotë me rregulloren “EU (EC) No 543/2009 on Crop Statistics”, dhe si të tillë</p>

	<p>raportohen të gjithë treguesit që kërkohen nga EUROSTAT.</p> <p>Niveli i detajimit të treguesve, prodhuar nga INSTAT realizohet nëpërmjet metodave vlerësuese të ekspertëve të fushës. Niveli i plotshmërisë të treguesve të prodhuar nga INSTAT duke konsideruar edhe detajimin e kërkuar sipas rregulloreve është afërsisht 80 %.</p>																		
13. Saktësia dhe besueshmëria																			
13.1. Saktësia e përgjithshme	Të dhënat e Statistikave të Bujqësisë ju referohen të dhënave administrative. Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit bimor bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave ndër vite.																		
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.																		
13.3. Gabim jo i kampionimit	Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabimi të mundshëm njerëzor. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit, bazuar në Politikën e Trajtimit të Gabimeve.																		
14. Afatet kohore dhe përpikmëria																			
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Statistikave të Bujqësisë publikohen (T+176 ditë) dhe (T+268 ditë) pas periudhës referuese. Më poshtë janë marrë parasysh dy periudha të ndryshme referuese për fushat përkatëse mbi të cilat mbështeten këto rezultate.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Statistikat e Bujqësisë</th> <th>Fusha Statistikore</th> <th>Periudha referuese</th> <th>Data e publikimit</th> <th>Afatet kohore</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>Prodhimin bujqësor</td> <td>12/31/2020</td> <td>6/25/2021</td> <td>176</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Sipërfaqja e Mbjellë</td> <td>9/30/2020</td> <td>6/25/2021</td> <td>268</td> </tr> </tbody> </table>	Statistikat e Bujqësisë	Fusha Statistikore	Periudha referuese	Data e publikimit	Afatet kohore		Prodhimin bujqësor	12/31/2020	6/25/2021	176		Sipërfaqja e Mbjellë	9/30/2020	6/25/2021	268			
Statistikat e Bujqësisë	Fusha Statistikore	Periudha referuese	Data e publikimit	Afatet kohore															
	Prodhimin bujqësor	12/31/2020	6/25/2021	176															
	Sipërfaqja e Mbjellë	9/30/2020	6/25/2021	268															
14.2. Përpikmëria	<p>Të gjitha afatet kohore respektohen në datat e paracaktuara në kalendarin e botimeve. Publikimi i të dhënave si pjesë e botimeve të ndryshme të INSTAT, ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100% të publikimeve të kryera.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Statistikat e Bujqësisë</th> <th>Fusha Statistikore</th> <th>Periudha referuese</th> <th>Data e shpallur</th> <th>Data e publikimit</th> <th>Vonesa në kohë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>Prodhimin bujqësor</td> <td>12/31/2020</td> <td>6/25/2021</td> <td>6/25/2021</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Sipërfaqja e Mbjellë</td> <td>9/30/2020</td> <td>6/25/2021</td> <td>6/25/2021</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>	Statistikat e Bujqësisë	Fusha Statistikore	Periudha referuese	Data e shpallur	Data e publikimit	Vonesa në kohë		Prodhimin bujqësor	12/31/2020	6/25/2021	6/25/2021	0		Sipërfaqja e Mbjellë	9/30/2020	6/25/2021	6/25/2021	0
Statistikat e Bujqësisë	Fusha Statistikore	Periudha referuese	Data e shpallur	Data e publikimit	Vonesa në kohë														
	Prodhimin bujqësor	12/31/2020	6/25/2021	6/25/2021	0														
	Sipërfaqja e Mbjellë	9/30/2020	6/25/2021	6/25/2021	0														
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria																			
15.1. Krahasueshmëria	Të dhënat mbi Statistikat e Bujqësisë janë gjithëpërfshirëse, ato prodhohen në nivel																		

gjeografike	vendi dhe sipas bashkive. Statistikat krahasohen sipas shpërndarjes gjeografike dhe rajonizimit të produkteve bujqësore.
15.2. Krahasueshmëria kohore	Informacioni statistikor mbi Statistikat e Bujqësisë grumbullohet në të njëjtën mënyrë duke datuar nga viti 2012, duke siguruar nje krahasueshmeri kohore prej 9 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=9). Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të ndryshme.
16. Kostoja e ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave të bujqësisë pranë sektorit të Statistikave të Tokës dhe Prodhimit Bimor është: 1 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT, pasi të dhënat e statistikave të bujqësisë sigurohen nga burime administrative të Drejtorive të Bujqësisë në qarqe në bashkëpunim me Sektorin e Statistikës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të Statistikave të Bujqësisë bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: <ul style="list-style-type: none"> • Politika e Revizionimit • Politika e Trajtimit të Gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast se burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Bujqësisë do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Statistikat e Bujqësisë mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Drejtorive të Bujqësisë në qarqe, me vlerësim ekspertesh. Të dhëna për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuese në nivel bashkie.
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat e Statistikave të Bujqësisë mbledhen në bazë vjetore.

18.3. Grumbullimi i të dhënave	Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave të Bujqësisë për vitin 2020, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike. Këto kontrolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet. Të dhënat e bujqësisë sigurohen nga burime administrative, në nivel vendi dhe sipas bashkive. Informacioni statistikor mundësohet në kohë.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	